



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 17 Mars 2023

Nr: 176

Ora: 12:00

V E N D I M

P Ë R

**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË SHQYRTIMIT ADMINISTRATIV TË DENONCIMIT TË KRYETARIT TË
DEGËS SË PARTISË DEMOKRATIKE ELBASAN NDAJ Z. GLEDIAN LLATJA, KRYETAR I BASHKISË
ELBASAN PËR SHKELJE ADMINISTRATIVE NË KUADËR TË ZGJEDHJEVE PËR ORGANET E
QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Në mbështetje të neneve 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre”, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

K O N S T A T O J :

Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n” e pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar përcakton kompetencat që ushtron Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

Referuar nenit 7, të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundrvajtjet administrative”, kompetenca për konstatimin e kundërvajtjes, me përjashtim të rasteve kur ligji parashikon ndryshe, i takon organit administrativ, përgjegjës për zbatimin e ligjit të posaçëm, titullarit të organit administrativ, që merret me zbatimin e ligjit, në rastet kur ligji nuk shprehet për kompetencën për shqyrtimin e kundërvajtjes dhe nxjerrjen e vendimit përkatës.

Bazuar në përcaktimet e nenit 7, të vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve:

Data: 17 Mars 2023

Nr: 176

Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të denoncimit të Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

- Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve fillon procedurën administrative dhe hetimin administrativ kryesisht me depozitim të denoncimit në Portalin e Denoncimeve ose kur ajo mbërrin drejtpërdrejtë në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
- Afati që ka Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për shqyrtimin administrativ të denoncimit është jo më i gjatë se 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga paraqitja e tij.
- Afati i parashikuar në pikën 2, të këtij neni mund të zgjatet me vendim me shkrim të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, kur çështja është komplekse ose është e nevojshme kryerja e hetimeve administrative shtesë.

Lidhur me denoncimin e Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike, Dega Elbasan ndaj Kryetarit të bashkisë Elbasan, nëpërmjet së cilit pretendohet se: *“Video e shpërndarë në rrjetet sociale “Facebook” nga kryetari i bashkisë Elbasan, z. Gledian Llatja, në kundërshtim me ligjin në minutat 0:25 e në vazhdim kryetari i bashkisë jep mesazhe politike për zgjedhjet e 14 Majit 2023. Gjithashtu aktiviteti publik nuk rezulton të jetë i raportuar në <https://aktivitete.kqz.gov.al/>”*. Bashkëlidhur këtij denoncimi është dërguar prova link:

<https://www.facebook.com/ljatja.gledian/videos/583592333590117/>

Referuar link-ut të mësipërm, kryetari i bashkisë, z. Gledian Llatja shkruan:

“Bashkëbisedim me pensionistët e Elbasanit për Pakon e Madhe dhe punët e mira që na presin në 4 vitet e ardhshme. #TëBashkuarJoTëNdarë #ShqipëriaEArdhmjaJonë #SkaKohëPërPushim”.

Edhe pse ka përfunduar afati 60 (gjashtëdhjetë) ditor i shqyrtimit të këtij denoncimi, hetimi administrativ është ende i papërfunduar, për shkak të kompleksitetit të çështjes objekt shqyrtimi.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronja “dh”, “f”, dhe “n” e pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 7, pika 3, e vendimit nr. 9, datë 9.4.2021, “Për procedurat e funksionimit dhe mirëmbajtjes së portalit, procedurat dhe afatet e hetimit administrativ të denoncimeve dhe vendimin që merret në përfundim të tyre” të Komisionit Rregullator, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

V E N D O S:

1. Zgjatjen e afatit të shqyrtimit administrativ të denoncimit ndaj Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike, ndaj Kryetarit të Bashkisë Elbasan.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palës nëpërmjet postës elektronike.

Data: 17 Mars 2023

Nr: 176
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të denoncimit të Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja, Kryetar i Bashkisë Elbasan, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 17 Mars 2023

Nr: 176
Ora: 12:00



“Për zgjatjen e afatit të denoncimit të Kryetarit të Degës së Partisë Demokratike Elbasan ndaj z. Gledian Llatja , Kryetar i Bashkisë Elbasan, për shkelje administrative në kuadër të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”